

Politika e plotë e privatësisë

Ofruesi dhe pala përgjegjëse

Schlossbräu mk | hotels GmbH
Stahlgruberring 43
81829 Munich
Telefon: +49 8723 9787-10
Fax: +49 8723 9787-190
info[at]schloss-mariakirchen.de

Regjistri Tregtar i Mynihut,
HRB 260154
Drejtorët Menaxhues: Johanna Lindner-Sonderfeld, Arno Sonderfeld

Numri i identifikimit të TVSH-së
sipas Nenit 27 të Ligjit Gjerman për TVSH-në:
DE337284235

Adresa e emailit të ofruesit: datenschutzbeauftragter@Lindner-Group.com

Shtesë për zbatimin në Republikën e Shqipërisë

Kjo politikë privatësie është përgatitur si përkthim/adaptim i politikës ekzistuese të privatësisë së ofruesit. Për aq sa përpunimi i të dhënave personale lidhet me subjektet e të dhënave në Republikën e Shqipërisë, kjo politikë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje edhe me Ligjin Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet nënligjore përkatëse të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në masën që ato janë të zbatueshme.

Personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

Personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale për mk hotel tirana është Begzana Hasanbelliu. Për çdo kërkesë, sqarim ose ankesë lidhur me përpunimin e të dhënave personale, subjektet e të dhënave mund të kontaktojnë personin përgjegjës nëpërmjet:

Nr. Tel: +35569 2199447

Email: begzana.hasanbelliu@mkhotels.de

Personi përgjegjës ndjek zbatimin e kësaj politike, këshillon strukturat përkatëse për masat organizative dhe teknike të mbrojtjes së të dhënave, koordinon trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave dhe shërben si pikë kontakti me autoritetin mbikëqyrës, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Llojet e të dhënave të mbledhura

Të dhënat personale të mbledhura nga ky aplikacion, qoftë në mënyrë të pavarur apo përmes palëve të treta, përfshijnë: cookies (gjurmues); të dhëna të përdorimit; emër; mbiemër; adresë email; adresë dorëzimi; informacion mbi pajisjen; të dhëna të transmetuara gjatë përdorimit të shërbimit; numër telefoni; të dhëna pagese.

Detaje të plota për çdo lloj të dhënash personale të përpunuara jepen në seksionet përkatëse të kësaj politike privatësie ose përmes teksteve shpjeguese specifike të paraqitura para mbledhjes së të dhënave.

Të dhënat personale mund të jepen lirisht nga përdoruesi nëse ose, në rastin e të dhënave të përdorimit, të mbledhen automatikisht gjatë përdorimit të këtij aplikacioni.

Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, ofrimi i të gjitha të dhënave të kërkuara nga ky aplikacion është i detyrueshëm. Nëse përdoruesi refuzon të japë të dhënat, ky aplikacion mund të mos jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e tij. Në rastet kur ky aplikacion shprehimisht deklaron se dhënia e të dhënave personale është vullnetare, përdoruesit janë të lirë të zgjedhin të mos i japin këto të dhëna pa pasoja për disponueshmërinë apo funksionimin e shërbimit.

Përdoruesit që nuk janë të sigurt se cilat të dhëna personale janë të detyrueshme mund të kontaktojnë ofruesin.

Çdo përdorim i cookies- ose mjeteve të tjera të gjurmimit- nga ky aplikacion ose nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të përdorura nga ky aplikacion, ka si qëllim ofrimin e shërbimit të kërkuar nga përdoruesi dhe çdo qëllim tjetër të përshkruar në këtë dokument.

Përdoruesit janë përgjegjës për të gjitha të dhënat personale të palëve të treta që merren, publikohen ose ndahen përmes këtij aplikacioni.

Lloji dhe vendodhja e përpunimit të të dhënave

Metodat e përpunimit

Ofruesi përpunon të dhënat personale të përdoruesve në mënyrë të rregullt dhe merr masa të përshtatshme sigurie për të parandaluar aksesin e paautorizuar, zbulimin, ndryshimin ose shkatërrimin e të dhënave.

Përpunimi i të dhënave kryhet duke përdorur kompjuter ose sisteme të bazuara në teknologjinë e informacionit, në përputhje me procedurat dhe metodat organizative të hartuara posaçërisht për qëllimet e deklaruara. Përveç kontrolluesit të të dhënave, persona të tjerë, si të brendshëm (burimet njerezore, shitjet, marketingu, departamenti ligjor, sistemet, administratorët) dhe të jashtëm – dhe në këtë rast të fundit, kur është e nevojshme, të caktuar nga kontrolluesi i të dhënave si përpunues të të dhënave (si p.sh. ofrues shërbimesh teknike, kompani dorëzimi, ofrues hostimi, kompani IT ose agjenci komunikimi) – mund të operojnë këtë aplikacion dhe për rrjedhojë të kenë akses në të dhëna. Një listë e përditësuar e këtyre palëve mund të kërket nga ofruesi në çdo kohë.

Vendodhja

Të dhënat përpunohen në selinë e ofruesit dhe në të gjitha vendodhjet e tjera ku ndodhen palët e përfshira në përpunimin e të dhënave.

Në varësi të vendodhjes së përdoruesit, transmetimet e të dhënave mund të përfshijnë transferimin e të dhënave të përdoruesit në një vend tjetër, jashtë vendit të tij. Për të mësuar më shumë mbi vendin ku përpunohen të dhënat e transferuara, përdoruesit mund të konsultojnë seksionin me informacion të detajuar mbi përpunimin e të dhënave personale.

Kohëzgjatja e ruajtes

Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë dokument, të dhënat personale do të përpunohen dhe ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe mund të ruhen për periudha më të gjata nëse kërkohet për të përmbushur një detyrim ligjor ose në bazë të pëlqimit të përdoruesit.

Qëllimet e përpunimit

Të dhënat personale të përdoruesit mblidhen me qëllim që ofruesi të mund të ofrojë shërbimin dhe gjithashtu të përmbushë detyrimet e tij ligjore, t'i përgjigjet kërkesave të autoriteteve, të mbrojë të drejtat dhe interesat e tij (ose të përdoruesve apo palëve të treta) si dhe të zbulojë aktivitetet keqdashëse ose mashtruese.

Përveç kësaj, të dhënat mblidhen për qëllimet e mëposhtme: shërbime platforme dhe hostimi, analiza (analytics) shfaqja e përmbajtjes nga platforma të jashtme, kontaktimi i përdoruesit, ndërveprimi me platforma chat në kohë reale, ndërveprimi me rrjete sociale dhe platforma të jashtme, shitja online e mallrave dhe shërbimeve, infrastruktura e hostimit dhe backend-it, menaxhimi i kontakteve dhe dërgimi i mesazheve, si dhe përpunimi i pagesave.

Përdoruesit mund të gjejnë informacione më të detajua mbi këto qëllime përpunimi dhe mbi të dhënat personale të përdorura për secilin qëllim në seksionin “Informacion i detajuar mbi përpunimin e të dhënave personale” të këtij dokumenti.

Informacion i detajuar mbi përpunimin e të dhënave personale

Të dhënat personale mblidhen për qëllimet e mëposhtme duke përdorur shërbimet e mëposhtme:

- Analiza (Analytics)

Shërbimet e listuara në këtë seksion i mundësojnë ofruesit të monitorojë dhe analizojë trafikun e të dhënave dhe të gjurmojë sjelljen e përdoruesit.

Google Analytics (Universal Analytics) (Google LLC)

Google Analytics (Universal Analytics) është një shërbim analize në web i ofruar nga Google LLC (Google).

Google përdor të dhënat e mbledhura për të gjurmuar dhe analizuar mënyrën se si përdoret ky aplikacion, për të përpiluar raporte mbi aktivitetet e tij dhe për t'i ndarë ato me shërbime të tjera të Google.

Google mund të përdorë të dhënat e mbledhura për të kontekstualizuar dhe personalizuar reklamat e rrjetit të vet reklamues.

Informacione të mëtejshme mbi përdorimin e të dhënave nga Google mund të gjenden në politikën e Partnerëve të Google.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues (trackers)

Vendi i përpunimit: Shtetet e Bashkuara - Politika e Privatësisë- Çregjistrimi (Opt Out)

Google Analytics (Universal Analytics) me anonimizim të IP-së (Google LLC)

Google Analytics (Universal Analytics) është një shërbim analize në web i ofruar nga Google LLC (Google).

Google përdor të dhënat e mbledhura për të gjurmuar dhe analizuar mënyrën se si përdoret ky aplikacion, për të përpiluar raporte mbi aktivitetet e tij dhe për t'i ndarë ato me shërbime të tjera të Google.

Google mund të përdorë të dhënat e mbledhura për të kontekstualizuar dhe personalizuar reklamat e rrjetit të vet reklamues.

Anonimizimi i adresës IP është aktivizuar në këtë faqe interneti, që do të thotë se Google do të shkurtojë adresën IP të përdoruesve brenda shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose në shtete të tjera që janë pjesë e Marrëveshjes së Zonës Ekonomike Evropiane përpara transmetimit. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, adresa e plotë IP do të transmetohet në një server të Google në SHBA dhe do të shkurtohet atje.

Informacione të mëtejshme mbi përdorimin e të dhënave nga Google mund të gjenden në Politiken e Partnereve të Google.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues.

Vendi i përpunimit: Shtetet e Bashkuara – Politika e Privatësisë -Çregjistrimi (Opt Out)

Shfaqja e përmbajtjes nga platforma të jashtme

Ky lloj shërbimi u mundëson përdoruesve të shohin dhe të ndërveprojnë me përmbajtje të hostuar në platforma të jashtme drejtpërdrejt brenda aplikacionit.

Ky lloj shërbimi mund të mbledhë ende të dhëna të trafikut në web për faqet ku është instaluar, edhe kur përdoruesit nuk janë duke e përdorur në mënyrë aktive.

Google Fonts (Google LLC)

Google Fonts është një shërbim vizualizimi fontesh i ofruar nga Google LLC, i cili i mundëson këtij aplikacioni të përfshijë përmbajtje të përshtatshme në faqet e tij.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues.

Vendi i përpunimit: Irlanda -Politika e Privatësisë

Google Maps widget (Google Ireland Limited)

Google Maps është një shërbim vizualizimi hartash i ofruar nga Google Ireland Limited, i cili i mundëson këtij aplikacioni të integrojë përmbajtje të tillë në faqet e tij.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues.

Vendi i përpunimit: Irlanda – Politika e Privatësisë

Instagram Widget (Meta Platforms Ireland)

Instagram është një shërbim virtualizimi i imazheve i ofruar nga Meta Platforms Ireland Limited, i cili i mundëson këtij aplikacioni të përfshijë përmbajtje përkatëse në faqet e tij.

Te dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues.

Vendi i përpunimit: Irlanda -Politika e Privatësisë.

Hosting dhe infrastruktura backend

Këto lloje shërbimesh janë të dizajnuara për të hostur të dhëna dhe skedarë në mënyrë që ky aplikacion të mund të menaxhohet dhe përdoret. Për më tepër, këto shërbime mund të ofrojnë një infrastrukturë të gatshme që menaxhon funksione specifike ose komponentë të plotë për këtë aplikacion.

Disa nga shërbimet e listuara më poshtë mund të operojnë, por jo domosdoshmërisht, përmes serverave të shpërndarë gjeografikisht, duke e bërë të vështirë përcaktimin e vendodhjes reale ku ruhen të dhënat personale.

OpenAI API (OpenAI, LLC)

OpenAI API nga OpenAI, LLC është një shërbim që mundëson automatizimin e detyrave përmes motorit të inteligjencës artificiale.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna të transmetuara gjatë përdorimit të shërbimit.

Vendi i përpunimit: Shtetet e Bashkuara -Politika e Privatësisë

Ndërveprimi me rrjetet sociale dhe platforma të jashtme

Këto lloje shërbimesh lejojnë ndërveprim me rrjete sociale ose platforma të tjera të jashtme drejtpërdrejt nga brenda këtij aplikacioni.

Ndërveprimi dhe informacioni i mbledhur përmes këtij aplikacioni janë gjithmonë subjekt i cilësimeve të privatësisë që përdoruesit kanë zgjedhur për rrjetin social përkatës.

Ky lloj shërbimi mund të mbledhë gjithashtu të dhëna të trafikut në web për faqet ku është instaluar, edhe kur përdoruesit nuk janë duke e përdorur në mënyrë aktive.

Rekomandohet që përdoruesit të dalin (log out) nga shërbimet përkatëse për të siguruar që të dhënat e përpunuara përmes këtij aplikacioni të mos lidhen me profilin e tyre.

Butoni “Like” dhe widget-et sociale për Facebook (Meta Platforms Ireland Limited)

Butoni ‘Like’ dhe widget -et sociale për Facebook janë shërbime që mundësojnë ndërveprimin me platformën Facebook.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues.

Vendi i përpunimit: Irlanda – Politika e Privatësisë

Ndërveprimi dhe platforma chat në kohë reale

Ky lloj shërbimi u mundëson përdoruesve të ndërveprojnë drejtpërdrejt me platforma chat të palëve të treta brenda këtij aplikacioni, duke u mundësuar atyre të kontaktojnë ose të kontaktohen nga ekipi i suportit të aplikacionit.

Nëse një shërbim i tillë është i instaluar, ai mund të mbledhë të dhëna navigimi dhe përdorimi në faqet ku është instaluar, edhe kur përdoruesit nuk janë duke e përdorur në mënyrë aktive shërbimin. Për më tepër, bisedat në chat në kohë reale mund të regjistrohen.

Facebook Messenger Customer Chat (Meta Platforms Ireland Limited)

Facebook Messenger Customer Chat është një shërbim për ndërveprim me platformën e chat-it në kohë reale Facebook Messenger, i ofruar nga Meta Platforms Ireland Limited.

Të dhënat personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues; të dhëna të trasmetuara gjatë përdorimit të shërbimit.

Vendi i përpunimit: Irlanda -Politika e Privatësisë.

Kontaktimi i përdoruesit

Formular kontakti (ky aplikacion)

Duke plotësuar formularin e kontaktit me të dhënat e tyre, përdoruesit autorizojnë këtë aplikacion të përdorë informacionin e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion, oferta ose kërkesa të tjera, sipas përcaktimit në titullin e formularit.

Të dhënat personale të përpunuara: gjurmues

Shitja online e mallrave dhe shërbimeve

Këto shërbime i mundësojnë ofruesit të shesë mallra ose shërbime dhe të gjenerojë të ardhura online. Për këtë qëllim, ofruesi mund, për shembull, të përpunojë pagesa, të ofrojë plane abonimi, të ndjekë porositë dhe të menaxhojë dërgesat përmes shërbimeve të listuara më poshtë.

Rezervimi online

Përdorimi i mjetit të rezervimit online DIRS21 nga TourOnline AG: Faqja jonë e internetit përdor mjetin e rezervimit online DIRS21 (ne vijim "OBT") nga TourOnline AG, Borsigstraße 26, 73249 Wernau, Gjermani (www.dirs21.de), në vijim "TOAG"), për të mundësuar rezervimet online të akomodimeve dhe shërbimeve të tjera turistike, si dhe për të përpunuar kërkesat.

TOAG përpunon të dhënat si kontrollues i të dhënave brenda kuadrit të OBT. Informacioni dhe dispozitat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave mund të gjenden në politikën e privatësisë se TOAG për OBT, të cilën mund ta aksesoni në çdo kohë brenda OBT ose në këtë link: <https://www.dirs21.de/datenschutz>.

Apaleo

2.1 Fusha e Zbatimit

Apaleo përpunon të dhënat e klientëve për të ofruar shërbime të menaxhimit të pronës (property management), siç përshkruhet në www.apaleo.com

2.2 Kohëzgjatja

Përpunimi do të kryhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës Kryesore.

Natyra dhe qëllimi i mbledhjes, përpunimit ose përdorimit të të dhënave

Apaleo ruan dhe përpunon të dhënat personale për të ofruar shërbimin dhe mbështetjen teknike përkatëse, siç përshkruhet:

Apaleo ruan dhe përpunon të dhënat e klientëve (mysafireve) në emrin tuaj.

Të dhënat:

- të dhëna identifikimi/pasaporte;
- emri;
- adresa e email-it;
- adresat dhe të dhënat e komunikimit;
- shtetësia;
- gjinia;
- data e lindjes;
- koment tekst i lirë (i cili teknikisht mund të përfshijë të dhëna personale);
- adresa e faturimit.

Përfituesit

Punonjësit e Apaleo që punojnë në zhvillimin e produktit dhe në suport mund të kenë akses në këto të dhëna për të ofruar mbështetje dhe ndihmë, ky akses është vetëm për lexim, përveç rasteve kur ju kërkon me shkrim modifikimin ose fshirjen e të dhënave.

Shërbime platforme dhe hostimi

Këto shërbime janë të dizajnuara për të hostuar dhe operuar komponentët kryesore të aplikacionit, duke mundësuar ofrimin e tij nga një platformë e unifikuar. Platforma të tilla i ofrojnë ofruesit një gamë mjetesh – përshembull, analiza dhe funksione komentimi, menaxhim përdoruesish dhe

bazash të të dhënave, e-commerce dhe përpunim pagesash-të cilat përfshijnë përpunimin e të dhënave personale.

Disa nga këto shërbime operojnë me serverë të shpërndarë gjeografikisht, duke e bërë të vështirë përcaktimin e vendodhjes së saktë ku ruhen të dhënat personale.

Wix (Wix.com, Ltd.)

Wix është një platformë e ofruar nga Wix.com, Ltd që i mundëson pronarit të ndërtojë, hostojë dhe operojë këtë aplikacion.

Wix është shumë e personalizueshme dhe mund të hostojë faqe interneti me përmbajtje që varion nga blogje të thjeshta deri në platforma komplekse e-commerce.

Të dhëna personale të përpunuara: adresa emaili; informacion mbi pajisjen; adresë dorëzimi; mbiemër; të dhëna përdorimi; gjurmues; emër.

Vendi i përpunimit: Izrael-Politika e Privatësisë

Përpunimi i pagesave

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, ky aplikacion përpunon të gjitha pagesat përmes kartave të kreditit, transfertave bankare ose mjeteve të tjera përmes ofruesve të jashtëm të shërbimeve të pagesave.

Në përgjithësi dhe përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, përdoruesve u kërkohet të japin të dhënat e tyre të pagesës dhe të dhënat personale drejtpërdrejt tek këta ofrues shërbimesh.

Ky aplikacion nuk është i përfshirë në mbledhjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave, por vetëm merr një njoftim nga ofruesi përkatës i shërbimit të pagesave në lidhje me faktin nëse pagesa është kryer me sukses.

Adyen (Adyen BV)

Adyen është një shërbim pagese i ofruar nga Adyen BV.

Të dhëna personale të përpunuara: të dhëna përdorimi; gjurmues; të dhëna pagese.

Vendi i përpunimit: Holanda - Politika e Privatësisë

Menaxhimi i kontakteve dhe dërgimi i mesazheve

Këto lloje shërbimesh mundësojnë menaxhimin e një baze të dhënash që përmban kontakte email-i, numra telefoni ose çdo informacion tjetër kontakti, me qëllim komunikimin me përdoruesin.

Këto shërbime gjithashtu mund të përdoren për të dërguar mesazhe tek përdoruesi. Gjithashtu mund të mbledhin të dhëna mbi momentin dhe kohën kur një mesazh është lexuar nga përdoruesi, si dhe kur përdoruesi ndërvepron me mesazhet hyrëse, për shembull duke klikuar mbi linket që përmbahen në to.

Twilio (Twilio, Inc)

Twilio është një shërbim i ofruar nga Twilio, Inc. për menaxhimin e numrave të telefonit dhe komunikimeve.

Të dhëna personale të përpunuara: numri i telefonit

Vendi i përpunimit: Shtetet e Bashkuara – Politika e Privatësisë

Informacione të mëtejshme për përdoruesit

Baza ligjore për përpunimin

Ofruesi mund të përpunojë të dhënat personale të përdoruesve vetëm nëse zbatohet një nga kushtet e mëposhtme:

- Përdoruesit kanë dhënë pëlqimin e tyre për një ose më shumë qëllime specifike;
- Mbledhja e të dhënave është e nevojshme për ekzekutimin e një kontrate me përdoruesin dhe/ose për masa paraprake kontraktuale që rrjedhin prej saj;
- Përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ligjor që i ngarkohet ofruesit;
- Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave legjitime të ofruesit ose të një pale të tretë.

Në çdo rast, ofruesi do të ofrojë informacion mbi bazën specifike ligjore mbi të cilën bazohet përpunimi, në veçanti nëse dhënia e të dhënave personale është një detyrim ligjor apo kontraktual ose një kusht për lidhjen e një kontrate.

Informacione të mëtejshme mbi kohëzgjatjen e ruajtjes

Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë dokument, të dhënat personale do të përpunohen dhe ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe mund të ruhen për periudha më të gjata nëse kërkohet për të përmbushur një detyrim ligjor ose në bazë të pëlqimit të ofruesit.

Prandaj:

- Të dhënat personale të mbledhura për qëllimin e përmbushjes së një kontrate ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit do të ruhen deri në përmbushjen e plotë të kësaj kontrate.
- Të dhënat personale të mbledhura për mbrojtjen e interesave legjitime të ofruesit do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur keto qëllime. Përdoruesit mund të marrin informacion më të detajuar mbi interesat legjitime të ofruesit në seksionet përkatëse të këtij dokumenti ose duke kontaktuar ofruesin.

Për më tepër, ofruesi lejohet të ruajë të dhënat personale për një periudhë më të gjatë nëse përdoruesi ka dhënë pëlqimin për një përpunim të tillë, për aq kohë sa ky pëlqim nuk është tërhequr.

Gjithashtu, ofruesi mund të jetë i detyruar të ruajë të dhënat personale për një periudhë më të gjatë nëse kjo është e nevojshme për të përmbushur një detyrim ligjor ose me urdhër të një autoriteti publik.

Pas përfundimit të periudhës së ruajtjes, të dhënat personale do të fshihen. Për rrjedhojë, e drejta e aksesit, e drejta për fshirje, e drejta për korrigjim dhe e drejta për portabilitet të të dhënave nuk mund të ushtrohen më pas përfundimit të kësaj periudhe.

Të drejtat e përdoruesve sipas Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)

Përdoruesit mund të ushtrojnë disa të drejta në lidhje me të dhënat e tyre që përpunohen nga ofruesi.

Përdoruesit kanë të drejtën, në masën e lejuar nga ligji, në veçanti të bëjnë sa vijon:

- Të tërheqin pëlqimin në çdo kohë. Nëse përdoruesi ka dhënë më parë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale, ai mund ta tërheqë këtë pëlqim në çdo kohë.
- Të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre. Përdoruesit kanë të drejtë të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre nëse përpunimi bazohet në një bazë ligjore tjetër përveç pëlqimit.
- Të marrin informacion mbi të dhënat e tyre. Përdoruesit kanë të drejtë të dinë nëse të dhënat e tyre po përpunohen nga ofruesi, të marrin informacion mbi aspekte të caktuara të përpunimit dhe të marrin kopje të të dhënave të tyre.
- Të kufizojnë përpunimin e të dhënave. Në këtë rast, ofruesi do të përpunojë të dhënat vetëm për qëllim ruajtjeje.
- Të kërkojnë fshirjen ose heqjen e të dhënave personale. Përdoruesit kanë të drejtë të kërkojnë që ofruesi të fshijë të dhënat e tyre.
- Të marrin të dhënat e tyre dhe t'i transferojnë tek një kontrollues tjetër. Përdoruesit kanë të drejtë të marrin të dhënat e tyre në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm dhe, kur është teknikisht e mundur, t'i transferojnë ato pa pengesa tek një kontrollues tjetër.
- Të paraqesin anekse. Përdoruesit kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë autoritetit përkatës mbikëqyrës.

Përdoruesit kanë gjithashtu të drejtë të informohen mbi bazën ligjore për transferimin e të dhënave jashtë vendit ose tek një organizatë ndërkombëtare ose është krijuar nga dy ose më shumë shtete (si p.sh. OKB), si dhe mbi masat e sigurisë të ndërmarra nga ofruesi për mbrojtjen e të dhënave të tyre.

Detaje mbi të drejtën për të kundërshtuar përpunimin

Nëse të dhënat personale përpunohen në interes publik, në ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë ofruesit, ose për qëllime të interesave legjitime të ofruesit, përdoruesi mund të kundërshtojë këtë përpunim duke paraqitur një arsye që lidhet me situatën e tij/saj specifike.

Përdoruesit informohen ose mund të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale për qëllime marketingu direkt në çdo kohë, pa pagesë dhe pa dhënë arsye. Nëse përdoruesi kundërshton përpunimin për qëllime marketingu direkt, të dhënat personale nuk do të përpunohen më për keto qëllime.

Përdoruesit mund të gjejnë informacion mbi faktin nëse ofruesi përpunon të dhëna personale për qëllime marketingu direkt në seksionet përkatëse të këtij dokumenti.

Si mund të ushtrohen këto të drejta

Të gjitha kërkesat për ushtrimin e të drejtave të përdoruesve mund t'i drejtohen pronarit duke përdorur të dhënat e kontaktit të dhëna në këtë dokument. Këto kërkesa mund të bëhen pa pagesë dhe do të përgjigjen nga ofruesi sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo me vonë se brenda një muaji, duke u siguruar përdoruesve informacionin e kërkuar ligjërisht.

Ofruesi do të komunikojë çdo korrigjim ose fshirje të të dhënave personale, apo kufizim të përpunimit, tek të gjithë përfituesit të cilëve u janë zbuluar të dhënat personale, nëse ka të tillë, përveç rasteve kur kjo rezulton e pamundur ose kërkon përpjekje disproporcionale. Ofruesi do të informojë përdoruesin për këta përfitues me kërkesë.

Informacione të mëtejshme mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

Masat ligjore

Të dhënat personale të përdoruesit mund të përpunohen nga ofruesi për qëllimin e ushtrimit të të drejtave ligjore ose në përmbajtje të procedurave ligjore që rrjedhin nga përdorimi i papërshtatshëm i këtij aplikacioni ose i shërbimeve të lidhura me të.

Përdoruesi pranon se ofruesi mund të detyrohet nga autoritetet të zbulojë të dhëna personale.

Informacione të mëtejshme mbi të dhënat personale të përdoruesit

Përveç informacionit të përfshirë në këtë politike privatësie, ky aplikacion mund, me kërkesë, t'i ofrojë përdoruesit informacion shtesë dhe më të detajuar në lidhje me shërbime specifike ose me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale.

Regjistrat e sistemit dhe mirëmbajtja

Ky aplikacion dhe shërbimet e palëve të treta mund të mbledhin skedarë që regjistrojnë ndërveprimet që ndodhin përmes këtij aplikacioni (log-et e sistemit) për qëllime operimi dhe mirëmbajtjeje, ose të përdorin të dhëna të tjera personale (p.sh. adresen IP) për këtë qëllim.

Informacion që nuk përfshihet në këtë politikë privatësie

Informacione të mëtejshme mbi mbledhjen ose përpunimin e të dhënave personale mund të kërkojnë nga ofruesi në çdo kohë duke përdorur të dhënat e kontaktit të dhëna.

Ndryshime në këtë politikë privatësie

Ofruesi rezervon të drejtën të ndryshojë këtë politikë privatësie në çdo kohë duke informuar përdoruesit në këtë faqe dhe, kur është e aplikueshme, përmes këtij aplikacioni dhe/ose -në masën që është teknikisht dhe ligjërisht e mundur duke dërguar një njoftim në të dhënat e kontaktit që disponon për përdoruesit.

Përdoruesit këshillohen të kontrollojnë këtë faqe rregullisht dhe, në veçanti, të vërejnë datën e ndryshimit të fundit të treguar në fund të faqes.

Nëse ndryshimet ndikojnë në përpunimin e të dhënave bazuar në pëlqimin e përdoruesit, ofruesi do të marrë një pëlqim të ri kur është e nevojshme.

Përkufizime dhe njoftme ligjore

Të dhënat personale (ose të dhëna)

Çdo informacion që, drejtpërdrejt ose në kombinim me informacione të tjera, identifikon ose mund të identifikojë një person fizik.

Të dhëna përdorimi

Informacion që ky aplikacion (ose shërbimet e palëve të treta që ky aplikacion përdor) mbledh automatikisht , si p.sh.: adresat IP ose emrat e domenit të kompjuterëve të përdoruesve që përdorin këtë aplikacion adresat URI (Uniform Resource Identifier), koha e kërkesës, metoda e përdorur për të dërguar kërkesën në server, madhësia e skedarit të përgjigjes së marrë, kodi numerik që tregon statusin e përgjigjes së serverit (rezultat i suksesshëm, gabim, etj), vendi i origjinës, karakteristikat e shfletuesit dhe sistemit operativ të përdorur nga përdoruesi, të dhëna të ndryshme kohore për çdo kërkesë (p.sh. sa kohë është kaluar në secilën faqe të aplikacionit), si dhe detaje mbi rrugën e ndjekur brenda aplikacionit, veçanërisht renditjen e faqeve të vizituara, si dhe informacione të tjera mbi sistemin operativ të pajisjes dhe/ose mjedisin IT të përdoruesit.

Përdoruesit

Personi që përdor këtë aplikacion, i cili, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, është i njëjtë me subjektin e të dhënave.

Subjekti i të dhënave (i prekur)

Personi fizik të cilit i përkasin të dhënat personale.

Përpunuesi i të dhënave

Person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit, siç përshkruhet në këtë politikë privatësie.

Pala përgjegjëse (ose ofuesi, ndonjëherë edhe pronari)

Personi fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që, i vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale, si dhe mjetet e përdorura për këtë qëllim, përfshirë masat e sigurisë që lidhen me funksionimin dhe përdorimin e këtij aplikacioni. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kontrolluesi është personi fizik ose juridik përmes të cilit ofrohet ky aplikacion.

Ky aplikacion

Mjeti hardware ose software që përdoret për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të përdoruesit.

Shërbimi

Shërbimi i ofruar përmes këtij aplikacioni, siç përshkruhet në kushtet përkatëse (nëse ka) dhe në kete faqe/aplikacion.

Bashkimi Evropian (BE)

Përveç nëse përcaktohet ndryshe, të gjitha referencat ndaj Bashkimit Evropian në këtë dokument i referohen të gjitha shteteve anëtare aktuale të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EEA).

Gjurmues (Tracker)

Termi 'gjurmues' i referohet çdo teknologjie -p.sh. cookies, identifikues unike, web beacons, skripte të integruara, e-tags ose fingerprinting- që mund të përdoren për të gjurmuar përdoruesit, për shembull duke mundësuar aksesin ose ruajtjen e informacionit në pajisjen e përdoruesit.

Njoftim ligjor

Kjo deklaratë zbatohet ekskluzivisht për këtë aplikacion, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë dokument.

Përditësuar për herë të fundit: 19 Shkurt 2025